



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 454/17 prot.

Datë 29.07.2025

**V E N D I M**

**Nr. 977/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                |            |
|----------------|------------|
| Fiorent Zguro  | Nënkryetar |
| Anila Malaj    | Anëtar     |
| Gjergj Mersini | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 29.07.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 393/2025, datë 21.03.2025 për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-20976-09-20-2024, me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikëseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj me fond limit 7,106,366.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-10-2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpetimi nga Zjarri” SHPK me L62102007V dhe adresë Rruga “Artan Lenja”, Hyrja Nr.1, Zone Kadastrale Nr.8210, Nr.Pasurie 1/301-N3, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë Adresë: “Rruga e Dibrës”, Nr. 372, Tiranë.

**Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “I-Fire” SHPK me NIPT, L71921002H dhe adresë: Tiranë, “Rruga Kavajes”, Pallati nr.4, Dyqani nr.9, Pranë Shkollës Teknologjike, ZK 8260, nr Pasurie 1/301, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:****I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 21.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.393/2025, ku vendosi: [...]

1. Të mos pranojë ankesën Nr. 454/2025 të operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF20976-09-20-2024, me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekanikoelektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj me fond limit 7,106,366.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-10-2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.
2. Të pranojë ankesën Nr. 630/2025 të operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK për procedurën e sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të riktheje procedurën në fazën e vlerësimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik si ofertues i kualifikuar.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë derdhjen në buxhet të shtetit të tarifës së paguar nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK të ankesës 454/2025.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK të ankesës 630/2025.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

1.2 Me shkresën nr. 532/8 prot., datë 17.07.2025, protokolluar me tonën nr. 454/14 prot., datë 21.07.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 393/2025, datë 21.03.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-20976-09-20-2024, me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikëseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj me fond limit 7,106,366.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-10-2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

## II

### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 532/8 prot., datë 17.07.2025, protokolluar me tonën nr. 454/14 prot., datë 21.07.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 393/2025, datë 21.03.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-20976- 09-20-2024, me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikëseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj me fond limit 7,106,366.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-10-2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka rikthyer procedurën e prokurimit në fazën e vlerësimit të ofrave, sipas konstatimeve të shprehura në vendimin nr.393/2025 të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-20976- 09-20-2024, me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikëseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj me fond limit 7,106,366.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-10-2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Anila Malaj

Anëtar  
Gjergj Mersini

Nënkryetar  
Fiorent Zguro

